

30

Ambasada PINK Shqipëri prezanton 30- personazhet e vitit 2014 Personazhet që kanë mbështetur publikisht kauzën LGBT

Për vitin 2014, PINK / LGBT Pro në konsultim me komunitetin LGBTI dhe persona që punojnë për këtë kauzë në vendin tonë kanë vendosur të prezantojnë një listë me personazhe publikë dhe jo publikë të cilët përmes punës së tyre, profesioneve që ushtrojnë, aktivizmit dhe angazhimit kanë dhënë një mbështetje në rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik për kauzën LGBT.

Kjo listë nuk është shtruese, dhe ne jemi të vetëdijshëm që shumë njerëz, të njohur ose jo për publikun, kanë dhënë dhe do të japin mbështetje për më shumë barazi, respekt dhe integritet të personave LGBTI në shoqërinë shqiptare. Ne jemi gjithashtu të vetëdijshëm se mbështetja më e madhe dhe e rëndësishme për çdo person LGBTI vjen nga nënat, baballarët, motrat, vëllezërit, shokët, shoqet, kolegët, mësuesit, mjekët etj në çdo çast e moment kur kjo ka qenë e nevojshme.

Gjithashtu, edhe vetë termi “mbështetje” është relativ. Nëse për disa personazhe publikë, si publicisti dhe shkrimtari Mustafa Nano apo deputetja Vasilika Hysi kjo mbështetje nën-kupton një angazhim serioz në media apo politikë, për dikë tjetër kjo mbështetje mund të jetë duke folur me miq e të njohur në mënyrë pozitive dhe mbështetëse për personat LGBT, duke

kundërshtuar batuta homofobike mes shoqërisë, duke reaguar denjësisht ndaj një mesazhi fyes dhe ofendues kundër personave LGBTI në mediat sociale etj.

Një tjetër efekt i konstatuar gjerësisht tek mbështetësit e kauzës LGBTI janë sulmet dhe kritikrat që ata kanë marrë nga njerëz të ndryshëm dhe rrethet e tyre shoqërore. Kjo tregon, se mbështetja nuk kërkon thjesht një mirëkuptim dhe dashamirësi, por kërkon gjithashtu kurajo dhe forcë nga njerëzit të cilët kanë dalë nga zonat e tyre të komfortit dhe kanë folur me zë dhe forcë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Disa nga personazhet e vendosur në këtë listë nuk janë domosdoshmërisht individë por mund të jetë edhe një institucion ose grup individësh që kanë dhënë mbështetje për kauzën LGBT.

Duke qenë të vetëdijshëm se mbështetja ndaj kauzës LGBTI vjen nga drejtime të ndryshme dhe në forma të ndryshme, ne i kërkojmë ndjesë njerëzve që nuk e gjejnë veten në këtë listë. Nëse njihni personazhe të tjerë të cilët kanë dhënë kontribut në mbrojtje të personave LGBTI dhe të drejtave të tyre na shkruani në adresën: pinkembassy@crca.al



Vjollca Meçaj – Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Znj. Meçaj ka mbështetur publikisht prej vitesh kauzën LGBT sidomos në aspektin e mbrojtjes ligjore, në forcimin dhe implementimin e ligjit anti-diskriminim dhe në pranimin shoqëror të personave LGBTI. Ajo ka folur publikisht edhe gjatë Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë në Festivalin e Diversitetit në Tiranë. Në një takim pune me parlamentarë shqiptarë dhe europianë Znj. Meçaj është shprehur se shoqëria shqiptare duhet të kuptojë se orientimi seksual apo identiteti gjinor është thjesht një karakteristikë më shumë e një individi dhe si e tillë nuk duhet të shërbejnë si motivim për ti diskriminuar apo veçuar.



Vasilika Hysi – Deputete e Parlamentit të Shqipërisë

Znj. Hysi është ndër figurat politike që ka punuar për shumë grupe vulnerabël, përfshi edhe ato LGBTI. Ndërkohë që mjaft politikanë kanë punuar për të avancuar çështje të cilat gëzojnë më shumë popullaritet në shoqëri, Znj. Hysi ashtu si shumë pak nga kolegët e saj në Kuvend, ka kontribuar me vendosmëri për mbrojtjen e të drejtave LGBTI. Në botëkuptimin tonë ajo nuk e ka bërë këtë as për të fituar pikë politike, as për famë. Në komentin e saj në lidhje me “Peticionin” e 57 intelektualëve pas Paradës së Krenarisë së këtij viti ajo shkruan: “Ka kohë që “intelektualët” nuk kanë thënë fjalën e tyre për shumë probleme që shqetësojnë njerëzit në këtë vend. Nuk flasin për fëmijët e ngujuar, për fëmijët e rrugës, për viktimat e trafikuar që shfrytëzohen prej vitesh në Europë, për mungesën e drejtësisë për personat e vrarë padrejtësisht në 21 janar, për viktimat e dhunës seksuale në Kosovë etj. Nuk flasin për reformat në arsim, në art, në shërbimet sociale e shumë reforma të tjera të nevojshme për t’u ndërmarrë në këtë vend. “Problemi” i zgjedhur për tu bërë publik ishte një zgjedhje e gabuar. Homofobia nuk është vlerë në një shoqëri demokratike, madje ajo është e dënueshme.”



Igli Totozani – Avokat i Popullit

Z. Totozani është një nga ato personazhe publikë që detyrën institucionale për të mbrojtur dhe respektuar të drejtat e njeriut e ka pasuruar me një angazhim qytetar të ngjashëm vetëm me personazhe publikë në vende me histori të gjatë demokracie dhe pluralizmi. Z. Totozani është gjithashtu ndër të paktët aleatë dhe mbështetës të kauzës LGBTI në vendin tonë, që vetëm sepse ka kryer detyrën e tij institucionale është përballur publikisht me sulme të ashpra politike dhe mediatike si dhe pa-kënaqësinë e shumë qytetarëve. Në një nga tryezat e punës për këtë çështje ai ka pranuar se puna për pranimin e qytetarëve LGBTI në shoqëri do të jetë shumë e gjatë dhe kjo sepse ka ende shumë pak njerëz që flasin hapur dhe lirshëm për këtë tematikë.



Aleksandër Arvizu – Ambasador i SHBA-ve në Shqipëri

Në përgatitjen e kësaj liste ne kishim dyshime nëse duhet të vendosnim apo jo qytetarë të huaj. Përshtypja e parë ishte se mos shumë njerëz do e quanin “të lehtë” mbështetjen e kauzës LG-BTI nga persona jo-shqiptarë. Por ndërkohë mos-futja në listë e tyre shumë bukur do dukej si ksenofobi dhe kompleks i çuditshëm që mbase ekziston në Shqipëri ndaj të huajve. Pas një bisede me grupin u duk e qartë se çdo person, pavarësisht pozicionit që ka, në rradhë të parë përfaqëson veten e tij / saj dhe se në Shqipëri ka me mijëra qytetarë të huaj, të cilët jo domosdoshmërisht kanë mbështetur publikisht këtë kauzë, edhe kur puna e tyre e ka kërkuar këtë gjë. Grupi i PINK e vlerëson Z. Arvizu si dhe stafin e tij pranë Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë, për punën e jashtëzakonshme që kanë bërë për mbrojtjen e personave LGBTI, ndërgjegjësimin shoqëror mbi këtë kauzë dhe vëmendjen që i kushtojnë sigurisë së aktivistëve LGBTI që vepronjë në vend.



Niko Peleshi – Zv. Kryeministër i Shqipërisë

Nga fjalimi në konferencën rajonale për të drejtat themelore, të zhvilluar në Tiranë në muajin Nëntor, Z. Peleshi u shpreh se: “Shqiptarët kanë disa përparësi në respektimin e minoriteteve dhe harmoninë fetare që ekziston në vend, çka ndikon në respektimin e të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim ka disa sfida për të përballuar. Një nga sukseset e mbrojtjes është krijimi i sistemit koordinues mes qeverisë dhe organizatave për veprime të përbashkëta për këtë komunitet. Debatet mediatike, përmirësimi i legjislacionit dhe ndërgjegjësimi publik, janë hapat e ndërmarrë që nuk kanë të krahasuar me ato të viteve më parë”.

Ema Ndreja - Aktore

Ndërkohë që në shumë vende të botës artistët janë shpesh në pararojë të çështjeve sociale dhe njihen si aktivistë të shumë kauzave, artistët shqiptarë, për arsye që nuk mund të analizohen lehtë, mbajnë një farë distancimi nga çështjet sociale. Por kjo gjë nuk mund të thuhet për aktoren e mirënjohur Ema Ndreja. Ajo është ndër ato artiste që njihet për sinqeritetin, revoltën ndaj padrejtësive, për ekspozimin e problemeve dhe vështirësive që kanë artistët në punën e tyre. Për personat LGBTI ajo ka thënë: “Unë kam qenë në krahun tuaj [personat LGBTI] në mënyrë të natyrshme, por kështu si unë nuk e mendojnë të gjithë. Dhe për këtë arsye unë mendoj se personat publikë kanë përgjegjësinë të flasin pikërisht për mbështetjen e tyre.” Më tej ajo ka pranuar se për shkak të mbështetjes që jep ndaj komunitetit LGBTI ka parë reagime të shoqëruara me ironi dhe nota agresive. “Në ato moment nisa të reflektoj më shumë mbi aktivitetin tuaj dhe e kuptova që ju jeni si një lokomotivë që i duhet të mbajë mbi supë barrën për të tërhequr gjithë shoqërinë përpara. Në këtë pika ngjasojmë bashkë”.





Gëzim Tushi – Sociolog

Përmes punës së tij të pasur shkencore si sociolog Z. Tushi ka qenë një nga të paktët intelektualë shqiptarë që ka folur për kauzën LGBT me një racionalizëm dhe seriozitet të admirueshëm. Duke qenë i vetdijshëm për kulturën dhe shoqërinë shqiptare ai ka dhënë këshillat dhe ka bërë një analizë jo thjesht pozitive për komunitetin LGBT por duke sjellë në pah të gjithë spektrin e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe duke i hequr ngjyrat emocionale. Z. Tushi po përgatit aktualisht një libër mbi çështjen LGBT.



Kujtim Çashku – Rregjizor & Producent

Z. Çashku është ndër ata artistë shqiptarë që mbështetjen për të drejtat e njeriut e jep çdo ditë jo vetëm me fjalë por me një punë të përditshme, të palodhshme. Përmes tij dhe ekipit që ai drejton Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi” në Tiranë nuk është vetëm çka përfaqëson emri por një hapësirë e vërtetë arti, kulture dhe debati e cila shërben si katalizator mendimi kritik dhe reflektimi për këdo që e viziton dhe frekuenton. Në fjalët e tij, dyert e Akademisë janë të hapura për çdo qytetar përfshi këtu edhe ata LGBTI. Akademia mirëpret çdo vit një Festival Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut ku tematika LGBTI prezantohet denjësisht ndërsa grupet LGBTI kane organizuar aty shfaqje filmash dhe debate.

Gilman Bakalli – Sociolog dhe Opinionist

Edhe pse Z. Bakalli nuk mund të quhet “mbështetës” i kauzës LGBTI në kuptimin klasik të fjalës, ne na ka bërë përshtypje një reagim i tij pas aktiviteteve të 17 Majit të këtij viti. Në analizën e tij ai sheh forcën e zakonit si pengesën më të madhe në respektimin e personave LGBTI dhe ka folur ndaj paragjyqimeve duke vënë në pikëpyetje vërtetësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre. Në shkrimin e tij ndër të tjera ai thotë: “Prej shekujsh martesë është një privilegj i heteroseksualëve. Dhe ngaqë askush nuk heq dorë kollaj nga privilegjet, është më se i vetëkuptueshëm reagimi emocional ndaj martesave homoseksuale. Por fakti që edhe unë nuk arrij të dal nga kurthi i forcës së zakonit, nuk më pengon të them se nuk ekziston asnjë argument racional, që mund t’i përjashtonte homoseksualët nga lidhja martesore. Argumenti kryesor që ndajnë bashkërisht shumë njerëz është se nga këto martesë nuk lindin fëmijë. Kushdo që e kthen aftësinë për të lindur fëmijë në një parakusht për lidhje martesore, duhet ta çojë deri në fund arsyetimin dhe të pranojë se, me këtë logjikë, para se të shkojmë tek nëpunësi i gjendjes civile për t’u kurorëzuar, duhet të bëjmë edhe testin e fertilitetit.



Për fat të mirë, kjo ide që e cenon dinjitetin e njeriut, nuk i ka vajtur deri tani askujt në mendje. Me këtë nuk dua të them se fëmijët nuk e pasurojnë jetën e një çifti të martuarish. Por nuk mund ta kuptoj se pse kjo vlerë, për disa njerëz, duhet të kushtëzohet nga dispozicioni seksual. Edhe e drejta e partnerëve të të njëjtit seks për të adoptuar fëmijë shkakton zemëratë për të njëjtën arsye. Forca e zakonit na e paraqet nën një dritë të çuditshme imazhin e dy grave apo dy burrave që rrisin një fëmijë. Por fakti që jemi mësuar për qindra vjet me imazhin e nënës dhe babait me fëmijë për dore nuk përbën argument për ta ndaluar këtë të drejtë edhe për partnerë të të njëjtit seks. Sigurisht që fëmijët e adoptuar të martesave gay mund të tallen e përqeshen në shkollë. Por edhe fëmijët nga martesa të përziera (racore, fetare) tallen e përqeshen në shkollë. Për mua, motivi kryesor, (megjithëse i pashprehur, ose i shprehur aty-këtu) që shkakton zemëratën e shqiptarëve kundër martesave të të njëjtit seks, është ideja se homoseksualët dhe lesbiket janë, në thelb, qenie perverse, prej të cilave fëmijët duhen mbajtur larg, sa më larg. Si dhe frika se nga prindër adoptues homoseksualë rriten fëmijë homoseksualë. A thua se nuk kanë qenë modele heteroseksuale martesore që kanë lindur e rritur fëmijë homoseksualë! Them se pak më shumë arsye dhe pak më pak emocion nuk do i bënte keq debatit. Aq më tepër kur debatin kanë marrë përsipër ta drejtojnë profesorë, prej të cilëve shoqëria pret përdorimin e intelektit.”

Gilman Bakalli



Znj. Bardhylka Kospiri – Zv. Ministre e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Znj. Kospiri ka qenë një mbështetëse e të drejtave LGBTI si aktiviste ashtu edhe tani në rolin e Zv. Ministres së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ajo ka qenë e pranishme në disa nga aktivitetet e organizatave LGBTI dhe ka ofruar mbështetjen e saj në përpjekjet për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI.



Mustafa Nano – Publicist, Opinionist & Shkrimtar

Z. Nano është një figurë publike shumë-dimensionale dhe publikimet e reagimet e tij prekin shumë çështje e tematika. Përsa i takon asaj LGBTI ai është nga të paktët figura publike që ka folur me kurajo dhe forcë, siç thotë edhe ati vetë “qëndrimi im është sulm. Është sulm ndaj atyre që nuk arrijnë të kuptojnë një nga gjërat më elementare të qytetërimit të sotëm. Askush nuk mund të tallet, përçmohet, diskriminohet, përndiqet për shkak të faktit që ai ka lindur apo është apo ka zgjedhur të jetë ndryshe nga ne në pikëpamje gjinore, racore, etnike, fetare, politike, seksuale etj dhe askush nuk ka të drejtë t’i japë vetes, bazuar tek fakti që është ndryshe një tagër për të përndjekur, apo përqeshur, apo përbuzur, apo diskriminuar të tjerët që s’janë si ai”.



Fatos Lubonja – Publicist & Opinionist

Lubonja ashtu si shumë nga personazhet e kësaj liste është një personazh shumë i vlerësuar nga komuniteti LGBTI në Shqipëri. Falë shkrimeve të tij ashtu si kolegu Nano, ai ka ndikuar jo pak në rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik ndaj kësaj kauze. Shumë pak njerëz të interesuar për këtë çështje nuk kanë lexuar shkrimin e tij me titullin “Unë jam homoseksual”. Në një ceremoni ku u vlerësua si mbështetës i komunitetit LGBTI Lubonja tha: “Ka dy lloje çmimesh, një lloj janë ato që ti jep maxhoranca e që duhet t’i refuzosh se me siguri ke bërë diçka që nuk shkon përderisa ta japin, dhe një çmim tjetër është ai që ta jep pakica apo minoranca e ky po, është një nder dhe diçka që jo vetëm nuk mund ta refuzoj por më duhet të pyes veten se çfarë kam bërë për ta merituar”.



Delina Fico – Aktiviste

Delina Fico, si aktiviste dhe mbështetëse e të drejtave të njeriut e ka mbështetur kauzën LGBT jo vetëm në debate e deklarata mediatike, por ka qëndruar mirfilli pranë komunitetit duke ofruar këshillim, ide dhe mbështetje. Edhe pse kauza LGBTI ka mjaft aleatë në rradhët e aktivistëve për të drejtat e vajzave dhe grave znj. Fico dallohet jo vetëm për aganzhimin por sepse ka kuptuar që burimi i diskriminimit dhe pasojat e tij janë të ngjashme si për arsye gjinore ashtu edhe ato të orientimit seksual.



Rudina Magjistari – Gazetare & Prezantuese

Rudina Magjistari ka bërë diçka të cilën shumë persona LGBTI në Shqipëri nuk do e prisnin nga pjesa më e madhe e show-bizit në Shqipëri; e ka prezantuar kauzën dhe tematikën për atë çka është, një çështje sociale që duhet zgjidhur dhe adresuar me thjeshtësi, mirëkuptim dhe racionalitet. Në studion e saj aktivistët e të drejtave LGBTI dhe mbështetësit e tyre kanë gjetur një mjedis nga ku nuk kanë bërë spektakël, nuk kanë zgjedhur dhunën dhe agresivitetin për të folur për një çështje të të drejtave të njeriut por kanë mundur të informojnë qytetarët mbi aktivitetet, mbi çështje të ndryshme dhe nevojat e problemet e komunitetit LGBTI.



Nora Malaj – Zv. Ministre e Arsimit dhe Sportit

Znj. Malaj ka mbështetur personat LGBTI, sidomos të rinjtë e këtij komuniteti si mësuese, drejtore shkolle gjithashtu edhe tani si politikane dhe si zv Ministre e Arsimit dhe Sportit. Ajo është ndër ato politikane që i njohin sfidat ndaj pranimit të komunitetit LGBTI dhe punën që të gjithë ne e mbi të gjitha institucionet duhet të bëjnë për këtë çështje. Ajo ka hedhur disa ide pozitive në lidhje me arsimin që kanë të bëjnë mbi të gjitha me përgatitjen e duhur të mësuesve aktualë dhe atyre të ardhshëm si dhe për të luftuar homofobinë dhe diskriminimin në mjediset shkollore dhe akademike.



Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka mbështetur prej disa vitesh punën dhe përpjekjet e komunitetit LGBT për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe përmirësuar politikat dhe shërbimet. Falë edhe përmirësimit të legjislacionit dhe vullnetit politik të Qeverive shqiptare në këto 6 vjet, kjo Ministri dhe administrata e saj kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm si për përmirësimet ligjore, fushatat ndërgjegjëse dhe projektet e ndryshme të zbatuara në bashkëpunim me këtë institucion. Aktualisht MMRS po punon për strategjinë e përfshirjes sociale si dhe po përgatit një plan të ri veprimi për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave LGBTI.



Elga Mitre – Këshilltare Politike pranë Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta

Elga Mitre është një personazh shumë i njohur dhe i respektuar në rradhët e komunitetit LGBTI për punën dhe përpjekjet e saj në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit. Përmes angazhimit të saj ajo më shumë se një herë ka ofruar zgjidhje për problematika dhe çështje të ndryshme dhe ka qenë iniciatore e disa tryezave të punës dhe shkëmbimeve midis aktivistëve LGBTI dhe partnerëve ndërkombëtarë.



Irma Baraku – Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisionerja Baraku është një personazh jo pak i njohur për komunitetin LGBTI. Vetë detyra dhe pozicioni i saj dhe ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, zbatimin e të cilit ajo mbikqyr direkt e kanë mbajtur në kontakt të vazhdueshëm me këtë komunitet. Në këto vite pune dhe përpjekjesh për njohjen e ligjit dhe luftimin e fenomenit të diskriminimit Znj. Baraku ka punuar për zbatimin e këtij ligji nga institucionet publike dhe private, në rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik për të gjitha komunitetet dhe grupet e diskriminuara, përfshi ato LGBTI dhe ka qenë në kontakt direkt dhe të përditshëm me organizatën tonë. Mbështetja ka konsistuar edhe në nën-shkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes dy institucioneve, në raportimin e rasteve direkt tek Komisionerja, në zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese, në zbatimin e projekteve dhe iniciativave të ndryshme etj. Së fundmi Zyra e Komisioneres ka publikuar edhe një raport të gjatë mbi çështjen LGBT me fakte, analiza, komente dhe sugjerime për përmirësime ligjore, ndryshime në politika etj.

Belioza Çoku – Aktiviste

Belioza Çoku ka mbështetur prej vitesh kauzën LGBT dhe është ndër të parat personazhe të shoqërisë civile që ka marrë pjesë aktive në debate televizive, në një periudhë kur kauza LGBT u bë sa e dëgjuar për publikun aq edhe e luftuar nga kundërshtarët e saj. Ndërkohë ajo ka qenë një nga njerëzit më mbështetës të komunitetit. Për disa vite rrjesht aktiviteti i saj “Kafe në PINK” ka qenë një mjedis mbështetës dhe këshillues për shumë të rinj e të reja LGBT, sidomos në momente të vështira familjare, profesionale apo shkolle.





Amarda Çoku – Eksperte Ligjore pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Është personi kontakti për komunitetin LGBT pranë Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këto vite ajo ka qenë pjesëmarrëse në pothuajse të gjitha aktivitetet e komunitetit LGBT, dhe ka dhënë kontribut shumë pozitiv në debatet dhe diskutime të zhvilluara. Pranë zyrës së Komisioneres ajo ka punuar për dy raporte të posaçëm mbi komunitetin LGBT dhe ka dhënë kontribut për ndërgjegjësimin e publikut edhe në aktivitete të ndryshme të zhvilluara nga Komisioneri.



Michael Kane – Ambasada e Mbreterise se Bashkuar

Është një nga personat e komunitetit ndërkombëtar në Tiranë që ka dhënë një kontribut shumë pozitiv për komunitetin LGBT. Vetëm në vitet e fundi ai ka asistuar në zhvillimin e një trajnimit për menaxhimin e qendrës së emergjencave LGBT si dhe në shfaqjen e një dokumentari britanik gjatë javës së Diversitetit 2014.

Eltin Qirazi – Pedagog

Është nga ata persona të akademisë dhe biznesit që kanë dhënë kontribut pozitiv në ndërgjegjësimin e shoqërisë për tematikën LGBT. Ambasada PINK ka patur mundësi që çdo vit të bëjë prezantime dhe klasa pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në klasat e zhvilluara prej tij.





Enila Cenko - Psikologe

Ajo gjithashtu ka ndihmuar në realizimin e disa klasave për tematikën LGBT pranë Universitetit të Neë York.

Luis Vivaldi - Vullnetar

Si vullnetar i Korpusit të Paqes, Luisi ka dhënë një mbështetje të jashtëzakonshme për kauzën LGBT në Shqipëri duke u përpjekur të angazhohet objektivisht dhe konkretisht. Me këmbëngulje dhe shumë punë ai arriti të zbatonte një projekt në bashkëpunim me Ambasadën PINK dhe organizatat e tjera në vend dhe të zhvillonte 15 mësimë dhe prezantime për diversitetin dhe kauzën LGBT në shkolla të ndryshme të mesme nëpër të gjithë Shqipërinë.





Bekim Asani – Aktivist LGBT

Bekimi është një nga aktivistët më frymëzues shqiptarë. Edhe pse ai punon dhe angazhohet për kauzën LGBT në vendlindjen e tij, Tetovë, sërish nuk ka hezitur të japë ndihmën dhe mbështetjen e tij për komunitetin LGBT në Shqipëri. Për Tirana Pride 2014, ai erdhi së bashku me një grup aktivistësh nga Tetova, duke i dhënë edhe më shumë ngjyra dhe atmosferë marshimit të krenarisë.

Ermira Shkurti – UNDP

Në punën e saj pranë UNDP Znj. Shkurti ka dhënë një kontribut të çmuar sidomos për çështje të barazisë gjinore. Duke marrë frymëzim edhe nga mbështetja që Kombet e Bashkuara kanë nisur të japin ndaj kësaj çështje Znj. Shkurti është angazhuar me disa nga aktivitetet e komunitetit LGBT. Ajo ka marrë pjesë në disa tryeza pune dhe ka diskutuar gjerësisht mbi tematikën dhe problematikën e ndryshme.



Z. Vangjush Dako
Znj. Nevila Xhindi
Z. Sotiraq Filo
Znj. Benila Tërrova
Z. Shpëtim Gjika
Z. Qazim Sejdini
Z. Lorenc Luka

Kryetarë dhe nën/Kryetarë Bashkitë Durrës, Tiranë, Korçë, Vlorë, Elbasan dhe Shkodër

Kryetarët dhe nënkryetarët e Bashkive Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Shkodër kanë shprehur të gjithë vullnetin pozitiv për të punuar mbi tematikën LGBT duke u njohur fillimisht me perceptimet e administratës së bashkive mbi këtë çështje, me zhvillimin e trajnimeve për punonjësit e Bashkive dhe institucioneve të tjera si edhe me zhvillim e aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjësuere për komunitetin LGBT në qytetet respektive.



www.respublica.al

Respublica – Portal Online

Është një nga mediumet më serioze në Shqipëri, dhe publikon shpesh lajme të cilat kanë përmbëjtje kritike sidomos mbi çështje të tilla si fjalimet e urrejtjes dhe diskriminimi.



Merita Poni – Pedagoge dhe Aktiviste e të Drejtave të Njeriut

Znj. Merita Poni është jo pak e njohur nga akademja, shoqëria civile, politika dhe mediat. Ajo është ndër ato personazhe publikë që mishërojnë në një person dijen intelektuale, disiplinën akademike, komunikimin mediatik, aktivizimin praktik dhe betejën për të mbrojtur grupet më vulnerabël në Shqipëri përfshi këtu gratë dhe personat me aftësi të kufizuar. Përsa i takon kauzës LGBTI Znj. Poni është ndër të parat intelektuale që folur publikisht dhe me kompetencë për çështjet e orientimit seksual apo identitetit gjinor dhe për punën që duhet bërë në këtë fushë. Në një diskutim për çështjen LGBTI ajo është shprehur: “Për sa kohë kjo frikë nga e ndryshmja [homoseksualiteti] nuk do sfidohet, atëherë homofobia dhe gjithë shfaqjet e saj do ti lenë homoseksualët në errësirën e qytetarit të dorës së dytë, pa të drejta themelore si ajo e familjes, e shkollimit, e punësimit, organizimit madje edhe e jetës, megjithë ligjet anti-diskriminuese që mund të aprovohen formalisht. Ajo çka homoseksualët kërkojnë nuk janë të drejta civile të veçanta, por të njëjtat të drejta civile që ka çdo qytetar dhe ata nuk do t’i kenë ato për aq kohë sa sjellja e tyre shihet si jo e denjë nën dritën e paragjyqimeve të padiskutueshme e negative të mitologjisë shoqërore. Homofobia ka pasojat të tmerrshme në jetën e homoseksualëve dhe të njerëzve përreth tyre. Homofobia ndan nënë e babë nga djali e vajza, shokun nga shoku, fqinjin nga fqinji, njerëzit nga njëri-tjetri dhe shoqërisë tonë që ka vuajtur shumë prej ndarjeve me natyrë paragjyquese nuk i duhen kufij të rinj ndarrës urrejtjeje. Për sa kohë që homofobia do të legjitimohet prej shoqërisë, fesë dhe politikës, homofobia do vazhdojë të rritet në forma të dhunshme dhe do mbetet paragjykimi i fundit i pranuar shoqërisht.”

Hueyda El Saied – Ambasadore e PINK

Hueyda ka mbështetur prej vitesh kauzën LGBT dhe prej dy vjetësh tashmë është Ambasadore e PINK. Edhe pse momentalisht nuk jeton në Tiranë ajo ka zhvilluar shpesh takime me komunitetin dhe ka dhënë mbështetjen e saj për shumë aktivitete të zhvilluara nga komuniteti dhe organizatat.

